



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministrit të Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 0106/2020

Datë: 19.12.2020

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 58 (paragrafi 6) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, si dhe në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (19.02.2020), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2020, Ministri i Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Caktohet Komisioni për pranimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara në Zyrën e Noterit Rasim (Xheladin) Behluli në Komunën e Rahovecit dhe dorëzimin e tyre në Gjykatën Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec , në këtë përbërje:

- 1.1. Erdon Gjinolli, Udhëheqës i Shërbimit Administrativ në Odën e Noterëve, Kryesues;
- 1.2. Admir Sadiku, Zyrtar Ligjorë në MD, anëtarë;
- 1.3. Shkelzen Zekaj, Arkivist, Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Rahovec, anëtarë.

2. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi, mban procesverbal për pranim-dorëzimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara.

3. Komisioni fillon punën nga dita e pranim-it të këtij vendimi dhe nuk duhet të ketë ndërprerje dhe shkëputje deri në përfundimin e kësaj çështje.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Selim Selimi

Ministër i Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Noterit, z. Rasim Behluli;
- Odës së Noterëve;
- Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec;
- Arkiv-it të Ministrisë së Drejtësisë.